



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

**V E N D I M**

Nr. 9, Datë 17/03, 2017

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr. Regj.06, datë 24.01.2017, të z. Leonard Berisha, kundër kundër Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, me pretendimin e diskriminimit “për shkak të gjuhës” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

Bazuar në deklaratimet e z. Leonard Berisha rezultojnë se me datë 15 dhjetor 2016, ka dorëzuar pranë Universitetit të Mjekësisë Tiranë, dokumentacionin e kërkuar për regjistrimin e tij në konkursin e mjekësisë për specializimet afatgjata të vitit 2017. Mes dokumenteve të dorëzuara ka qenë edhe dëshmia e provimit për njohjen e gjuhës së huaj (gjuhës italiane), e lëshuar nga Universiteti i Tiranës në vitin 2005.

Me shkresën me nr.1119/34 prot., datë 20.12.2016 “Vendim nr.7, datë 20.12.2016” të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, është miratuar lista emërore e aplikantëve për specializime afatgjata në këtë universitet, që plotësojnë kriteret për të vazhduar konkurrimin. Z. Leonard Berisha ka rezultuar mes kandidatëve të cilët plotësonin kriteret për të marrë pjesë në konkurrim, i renditur me numrin rendor 219 të kësaj liste. (Lista kishte gjithsej 310 kandidatë të përzgjedhur).

Më pas, me shkresën me nr.1119/39 prot., datë 29.12.2016 “Vendim nr.10, datë 29.12.2016”, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, ka shpallur një listë të dytë, të ndryshuar nga e para, me gjithsej 169 kandidatë të përzgjedhur, të cilët plotësonin kriteret për të marrë pjesë në etapat e mëtejshme të konkurrimit.



Adresa: **Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë**  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Subjekti ankues nuk rezultoi ta kishte emrin në këtë listë dhe argumentimi i dhënë nga Universiteti i Mjekësisë së Tiranës, ishte se kandidatura e tij ishte skualifikuar për shkak se dokumenti me të cilin ai provonte njohjen e gjuhës së huaj, nuk njihej.

Z. ...ard Berisha shprehet se në njoftimin e konkursit nuk specifikohet as niveli, as institucioni në të cilin kërkohet të ishte realizuar mbrojtja e gjuhë së huaj. Për më tepër, ai shprehet se cënimi i së drejtës së tij për të konkuruar bëhet akoma më i rëndë pasi nuk ka ku të drejtohet për të mbrojtur gjuhën italiane që zotëron, pasi Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk ka ndonjë marrëveshje me ndonjë institucion tjetër brenda territorit të Shqipërisë.

Ankuesi pretendon se i është mohuar e drejta për të konkuruar, duke e diskriminuar dhe trajtuar në mënyrë të padrejtë, pasi në listën e parë ai ishte shpallur i kualifikuar për të vijuar më tutje në konkurrim, ndërsa në listën e dytë ishte skualifikuar.

Për sa më sipër, ankuesi kërkon nga Komisioneri, të rivendosë në vend të drejtën e tij për të konkuruar në kursin afatgjatë për mjekësi pranë Universitetit të Mjekësisë në Tiranë, si dhe të pezullojë zhvillimin e konkurrimit deri në zgjidhjen e çështjes së tij.

Ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna prej subjektit ankues, në lidhje me shkaqet e pretenduara prej tij.

- Për këtë arsye, me shkresën me nr.57/1 prot., datë 06.02.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ka kërkuar ankuesit të paraqesë dokumentet provues për pretendimin e tij, (lidhur me shkaqet e pretenduara) meqenëse ankuesi nuk i ka bashkëngjitur ankesës dokumentet shkresore që t'i provojë ato dhe as ka parashtruar argumentime lidhur me këtë fakt.

Përsa më lart, ankuesi nuk solli asnjë përgjigje, dokument, provë apo parashtrim ku të shpjegonte apo mbështeste pretendimet e tij.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
 Tel: +355 4 2431078  
 Fax: +355 4 2431077  
 e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
 web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të provohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Lidhur me sa më sipër, ankuesi nuk ka paraqitur asnjë fakt apo provë për të provuar lidhjen shkakësore për diskriminimin e tij nga ana e Universitetit të Mjekësisë Tiranë, për shkaqet e pretenduara.

Bazuar në nenin 33, pika 4/b/ç, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, nuk përmbushen kriteret e përcaktuara nga ky Ligj, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

#### PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 2, si dhe në nenin 33, pika 4/b/ç, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

**Irma BARAKU**



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
 Tel: +355 4 2431078  
 Fax: +355 4 2431077  
 e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
 web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)